

SHKOLLAT PUBLIKE TË GARFIELD-IT

ANNA SCIACCA

34 OUTWATER LANE, GARFIELD, NEW JERSEY 07026
973-340-5000

Mbikëqyrësja e Shkollave

asciaccia@gboe.org

1 Gusht, 2022

Të gjithë anëtarëve të Komunitetit të Shkollave të Garfield-it:

MIRËSEVINI NË VITIN SHKOLLOR 2022-2023!

Po presim me padurim hapjen e shkollës me mësim në person për të gjithë nxënësit të mërkurën më 7 shtator. Viti shkollor do të fillojë me një sesion më 7, 8 dhe 9 shtator dhe orari i plotë ditor do të fillojë të hënën, më 12 shtator.

Ndërsa vazhdojmë t'i japim përparësi shëndetit dhe sigurisë në shkollat tona, distrikti do të ndjekë rekomandimet e CDC-së, Departamentit lokal të Shëndetit dhe Departamentit të Edukimit në New Jersey, kur të zbatojmë protokollet në lidhje me COVID-19. Distrikti do të zbatojë modelin Testohu për të Qëndruar, i cili kombinon gjurmimin e kontakteve dhe testimin e menjëhershëm për COVID-19 për të lejuar individët që janë në kontakt të ngushtë dhe ata asimptomatikë të qëndrojnë në shkollë. Kërkohej leja e prindërve për t'u testuar në shkollë dhe fleta e lejës do të postohet në portalin e shkollës së bashku me informacione shpesh në lidhje me procedurën "Testohu për të Qëndruar" (TTS) në mënyrë që prindërit të marrin një vendim të informuar.

Distrikti Garfield ka rishikuar dhe postuar një plan në faqen e internetit të distriktit të titulluar, *Plani i Distriktit Garfield për Kthim të Sigurt të Mësimin në Person dhe Vazhdimësisë së Shërbimeve*, përditësuar në korrik 2022, i cili i siguron komunitetit shkollor protokollet tona specifike për vitin e ri shkollor. Ky plan është një dokument i vazhdueshëm dhe i nënshtrohet rishikimeve të menjëhershme në rast të dukurive të papritura në lidhje me numrin e rasteve të COVID-19 apo variantet e tij në rrethin, komunitetin, qarkun dhe shtetin tonë. Mbajtja e maskave mbetet fakultative për stafin, studentët dhe vizitorët në shkollat dhe zyrat tona.

Një kompleks i ri atletik do të ndërtohet në Shkollën e Garfield-it! Projekti do të përfshijë një rinovim të plotë të kompleksit të tanishëm atletik. Këto përmirësime përfshijnë instalimin e fushave me terren sintetik të shumë-qëllimshme si për futboll Amerikan, futboll, bejsboll, dhe softboll si dhe një pistë me 8 korsi që përfshin kërcim së gjati, kërcim trefishi, kërcim me shtizë dhe kërcim së larti, zona të caktuara për hedhjen e shtizës, hedhjen e diskut dhe gjuajtjen, fusha tenisi të sapondërtuara, vënde për t'u ulur në stadium në përputhje me rregullat e ADA (persona me aftësi të kufizuara), ndriçim në terren, një tabelë video dixhitale që tregon rrezultatet, si dhe një vend të ri në terren me banja, dhoma zhveshjeje dhe vend për ruajtjen e sendeve personale. Me të përfunduar, ky kompleks modern do të shërbejë si qendër për atletikën dhe aktivitetet rikrijuese të Garfield-it dhe do të jetë i disponueshëm për evenimente të rrethit dhe të qytetit, si dhe për përdorim nga organizatat e komunitetit dhe banorët e Garfield-it.

Një shkollë e re Fillore me klasat K-5 po bëhet në Garfield!

Departamenti i Zhvillimit të Shkollave në New Jersey së fundmi njoftoi miratimin e projekteve të reja në Planin e tij Kapital të 2022 që adreson nevojat për objekte në rrethet më të mbipopulluara të shtetit. Lajmi emocionues është se Garfieldi do të ketë një shkollë të re fillore K-5 me kapacitet për të arsimuar 750-800 nxënës. Prona e caktuar për këtë projekt është zona aktuale e Shkollës #5 Woodrow Wilson, që ndodhet në Outwater Lane në Garfield. Data e parashikuar e hapjes së shkollës së re është shtatori i 2026.

Akademia e Suksesit do të hapet në Shkollën e Mesme të Garfield!

Ky program i ri do t'ju krijojë studentëve tanë mundësi jo-tradicionale të dizenuara për të plotësuar nevojat e tyre specifike dhe të përshtatura ndaj stileve individuale të të mësuarit. Akademia e Suksesit do t'i lejojë studentët në rrezik dështimi akademik të rikuperojnë kreditet duke adresuar sfida të tilla si mungesa e shkollës, mungesa e motivimit dhe çështjet socialo-emocionale. Ne kërkojmë të gjejmë rrugëzgjdhje të personalizuar në mënyrë që studentët tanë të arrijnë qëllimet e tyre dhe të jenë të suksesshëm.

Financimi ESSER vazhdon t'i ofrojë distriktit mundësinë për të vendosur një fokus të qëllimshëm në mësimin social-emocional (SEL), shëndetin mendor, humbjen e të mësuarit që ndodhi gjatë pandemisë dhe çështjet e shëndetit dhe sigurisë. Këshillues shtesë janë punësuar për të ofruar mbështetje emocionale dhe mentorim për studentët tanë, ndërsa synojmë të promovojmë një ambient shkollor pozitiv që studentët tanë të lulëzojnë. Financimi do të përdoret për të ofruar mbështetje dhe pasurim akademik si dhe social-emocional përmes mësimdhënies, programeve ditore të zgjatura dhe programeve verore. Teknologjia do të përmirësohet sipas nevojës për t'u ofruar studentëve tanë mundësinë për mësim të personalizuar dhe zhvillimin e aftësive thelbësore të shekullit të 21-të. Mësuesit do të vazhdojnë të marrin zhvillimin përkatës profesional e të vazhdueshëm për t'i fuqizuar ata që të japin mësim në mënyrë sa më efektive dhe të adresojnë nevojat e studentëve tanë.

Përmirësimet e objekteve për këtë vit shkollor përfshijnë sistemin e ri HVAC në shkollën e mesme të Garfield-it, i cili është një rinovim total i sistemit aktual për të përmbushur standardet mjedisore, duke përfshirë ajrin e kondicionuar. Shkolla sipër elementare do të shohë përfundimin e projektit të teatrit, i cili përfshin teknologjinë dhe ndriçimin më modern për të inkurajuar kështu pjesëmarrjen e studentëve në art. Mirëmbajtja e vazhdueshme e ndërtesave është thelbësore në shkollat tona fillore dhe kjo përfshin lysterjen, shtrimin e dyshemeve dhe riparimet sipas nevojës.

Distrikti Garfield priorizon sigurinë e shkollës dhe do të vazhdojë të ketë roje sigurie të armatosur në çdo shkollë. Personeli i sigurisë është përgjegjës për ruajtjen e një mjedisi të sigurt, përmbushjen e kërkesave të stërvitjes të detyrueshme mujore si dhe kontrollimin e të gjithë vizitorëve që hyjnë në shkollë duke përdorur sistemin e menaxhimit Raptor. Çdo shkollë është e pajisur me kamera të vendosura në mënyrë strategjike si dhe sisteme alarmi dhe butona paniku për raste emergjence.

Rregulloret për shkollat parashkollore, fillore, shkollën pas-fillore dhe shkollën e mesme do të postohen në faqet e internetit të distriktit dhe shkollës me informacion në lidhje me procedurat e frekuentimit, oraret e shkollave, kodet disiplinore dhe informacione të tjera përkatëse. Është e rëndësishme të familjarizoheni si ju dhe dhe fëmija juaj me rregullat dhe protokollet e shkollës përpara fillimit të vitit shkollor.

Kontrolloni faqen e internetit të distriktit dhe shkollës për informacion mbi programin shkollor. Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin që fëmijët e tyre të mos marrin pjesë në mësim për tema të ndryshme, prandaj është e rëndësishme që ju të shikoni informacionin e disponueshëm që të merrni vendimin më të mirë për edukimin e fëmijës suaj.

Komunikimi reciprok është thelbësor për suksesin e studentëve në mësim. Mos harroni të kontrolloni rregullisht faqet e internetit të distriktit dhe shkollës, si dhe llogaritë e mediave sociale të distriktit dhe kontaktoni drejtorin, mësuesit dhe këshilluesit e nxënësve nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim. Ne punojmë së bashku si një ekip për të edukuar studentët tanë.

Po u shpreh urimet e mia më të mira gjithë studentëve, stafit dhe familjeve tona për një vit shkollor të sigurt, të shëndetshëm, të suksesshëm dhe të lumtur, ndërsa ne vazhdojmë të ndjekim **Vizionin tonë të Kampionëve për të "Inkurajuar, frymëzuar dhe mbështetur çdo individ për të arritur sa më shumë"**. Shpresoj ta shijoni pjesën e verës dhe të jini sa më mirë.

Përshëndetje të përzemërta,

Anna Sciacca

Mbikqyrëse e Shkollave Publike të Garfield-it